

# Buletini



REPUBLIKA E KOSOVËS  
**KOMUNA E LIPJANIT**

REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
OPŠTINA LIPJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



## QERSHOR 2023

# Me mbështetjen e Kryetarit Ahmeti, Komuna e Lipjanit shënon Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve



Me aktivitete të shumta në qytetin e Lipjanit me mbështetje të Kryetarit të Komunës z. Imri Ahmeti po shënohet 1 Qershori, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve.



“Është një ditë për të festuar, por gjithashtu për të reflektuar dhe për të marrë angazhime të reja për të krijuar një botë më të mirë për të ardhmen e tyre. Le të nderojmë fëmijët sot dhe çdo ditë, duke i dhënë atyre dashurinë, mbështetjen dhe hapësirën për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë”, tha kryetari Ahmeti.

**Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim, z. Valon Pacolli së bashku me Shefin e kabinetit të Kryetarit, z. Avni Jashari, pritën në takim përfaqësueset e Dhomës së Tregtis dhe Industrisë së Kosovës, me të cilat shkëmbyen informata lidhur me mundësit e zhvillimit ekonomik lokal dhe mundësitë që Komuna e Lipjanit ofron për investim.**



**Në këtë takim po ashtu në mes tjerash Drejtori Pacolli i informoi lidhur me zhvillimin e Zonës Ekonomike, Parkun Industrial në Qylagë si dhe aktivitetet tjera që ndermerr komuna për arritjen e një ambienti të mirë të të bërit biznes.**



**Bashkëpunimi me Dhomës së Tregtis dhe Industrisë së Kosovës pritet që së shpejti të finalizohet edhe me nënshkrimin e një memorandum bashkpunimi.**

**Pas reshejeve të shumta të shiut në Janjevë të cilat kanë shkaktuar dëme në infrastrukturën publike, kryetari i komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti së bashku me përfaqësuesit e drejtorateve përkatëse kanë dalur në teren për të parë nga afër dëmet e shkaktuara nga të reshurat e shiut.**



# Nderohet me homazhe Heroi Lulzim Llugiqi



**Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi së bashku me bashkëpunëtor ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqet me lule pranë lapidarit të Dëshmorit të Kombit Lulzim Llugiqi, me rastin e 24 vjetorit të rënjes së tij.**



**Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti me bashkëpunëtorë ka zhvilluar takim me përfaqësues të grupit të Donatorëve nga Granti i Përformancës Komunale, me të cilët kanë diskutuar rreth ndryshimeve pozitive që kanë sjellur projektet e realizuara përmes këtij granti dhe sfidat me të cilat është ballafaquar komuna përgjatë kësaj periudhe.**



për standardet e punës që janë krijuar në përformancën komunale. Bazuar në indikatorët matës janë krijuar detabaza shumë të mira të cilat po na shërbejnë në hartimin e buxhetit dhe në planifikimet e tjera për të ardhmen. Rezultatet e këtyre raporteve janë ndihmesë e madhe për ne dhe punën tonë në vazhdimësi”, është shprehur kryetari Ahmeti.



vazhdueshme që mjetet financiare të donatorëve të cilat fitohen nga komunat për përformancën e tyre, të mos i humbin komunat në fund të vitit ashtu siç humbin mjetet nga granti qeveritar të cilat nuk arrijnë të shpenzohen brenda vitit kalendarik.

# Filluan punimet në ndërtimin e trotuarit në rrugën Gadime – Llugaxhi



Drejtori i infrastrukturës z. Sead Aliu së bashku me përfaqësuesit e ekzekutivit kanë përcjellur nga afër fillimin e punimeve në ndërtimin e trotuarit në rrugën Gadime - Llugaxhi e cila shtrihet përgjatë rrugës kryesore të këtyre fshatrave. Ky projekt është dy vjeçar dhe financohet nga Komuna e Lipjanit.



#komunaelipjanit

**“Margaritarët e gjuhës sonë” është libri i autores Miradie Shamolli Leku që u përuruar sot në Bibliotekën e qytetit në Lipjan.**



**Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi ka uruar autoren për botimin e këtij libri dhe ka shprehur gatishmërinë e Komunës që botime të tilla të përkrahen edhe në të ardhmen.**



**Ky libër me poezi dhe proza do t'i shërbej nxënësve të klasëve të para dhe do të pasuroj bibliotekat shkollore.**



# Fillojnë dëgjimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore për periudhën 2024-2026



Me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, Komuna e Lipjanit sot ka filluar Dëgjimet Publike për planifikimin e buxhetit për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024 – 2026.



Takimet e para janë zhvilluar në sallën e Kuvendit të Komunës me anëtarët e Kuvendit, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, pastaj ka vazhduar edhe me Shoqatat e Grave, Shoqërinë Civile, Personat me Aftësi të Kufizuara, Shoqatat e të Rinjve, Klubet Sportive, Fermerët e Komunës së Lipjanit dhe me banorët e qytetit të Lipjanit.

# Kanë vazhduar dëgjimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore për periudhën 2024-2026



Komuna e Lipjanit ka vazhduar me mbajtjen e dëgjimeve për planifikimin e buxhetit për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024 – 2026, me banorët e fshatrave Gadime, Dobrajë të Madhe dhe Shalë si dhe me banorët nga fshatrat e tyre përreth.



Gjatë këtyre takimeve qytetarë të shumtë kanë pasur rastin të bëjnë propozimet e tyre në mënyrë që ato të inkorporohen në planifikimin buxhetor për KAB 2024 – 2026.

Takimet vazhdojnë edhe ditën e nesërme në fshatin Grackë e Vjetër.

**Me një program të pasur kulturo-artistik, të përgatitur nga nxënësit dhe mësuesit e shkollës, SHFMU “Ibrahim Banushi” në Shalë ka shënuar ditën e shkollës.**



**Me këtë rast u përkujtua edhe Dëshmori Ibrahim Banushi, ku nga përfaqësues të egzekutivit të Komunës së Lipjanit u vendosën kurora lulesh pranë lapidarit të dëshmorit.**



# Ndalohet qarkullimi i trotinetëve elektrik në sheshin e qytetit “Adem Jashari”

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti ka nxjerrë një urdhëresë me të cilën ndalohet qarkullimi i të gjithë trotinetëve elektrik, biçikletave elektrike dhe motoçikletë apo moped elektrik, në sheshin e qytetit “Adem Jashari”, në Lipjan.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë

## URDHËRESË

- I. **NDALOHE**T, qarkullimi i të gjithë trotinetëve elektrik, biçikletave elektrike dhe motoçikletë apo moped elektrik .
- II. Ndalimi i qarkullimit të mjeteve të cekura në pikën I të kësaj Urdhërese bëhet për sheshin e qytetit “Adem Jashari” në Lipjan.
- III. Sektori për marrëdhënie me publikun do t'i njoftojë qytetarët dhe subjektet tjera për këtë Urdhëresë, përmes mediave të shkruara dhe elektronike.
- IV. Për zbatimin e kësaj Urdhërese do të kujdeset Drejtorati për Inspeksion, Stacioni Policor në Lipjan dhe Sektori për marrëdhënie me publikun.
- V. Urdhëresa hyn në fuqi menjëherë.

Urdhëresa i dërgohet:

- Stacionit Policor në Lipjan
- Drejtoratit për Inspeksion
- Sektorit për Marrëdhënie me Publikun

INr. 345/02-29907  
Lipjan, më 09.06.2023

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti

Për zbatimin e kësaj Urdhërese do të kujdeset Drejtorati për Inspeksion, Stacioni Policor në Lipjan dhe Sektori për marrëdhënie me publikun.

Urdhëresa hyn në fuqi menjëherë.

**Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me shoqatën e pedagogëve të sporteve shkollore në Lipjan si dhe Federatën e Futbollit të Kosovës për dy ditë radhazi kanë organizuar garat në futboll për vajzat e moshës 9 deri ne 13 vjeçare, ky aktivitet është organizuar në kuadër të javës së kulturës.**



**Drejtori i Arsimit z. Rasim Hasani ka thënë se qyteti i Lipjanit është shëndrruar në qendër të organizimeve sportive në gara të ndryshme, andaj ne i kushtojmë rëndësi të veçantë organizimeve të tilla pasi që kështu do ti edukojmë gjeneratat e reja në masivizimin e sportit, ne si komunë gjithmonë do te jemi partner në organizime të tilla e të cilat kanë karakter socializues por edhe edukues për të rinjtë tanë.**



**Pas përfundimit të garës drejtori Hasani ka ndarë pllakata mirënjohëse për organizatorët dhe ekipet fituese të cilët i ka falenderuar për organizimin e kësaj gare dhe ka potencuar se Komuna e Lipjanit do të jetë përherë mbështetës në organizime të tilla.**

# Mbahet panairi P-GJASHT-ë

Me mbështetje të Komunës së Lipjanit në SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në qytet, në Shënimin e Ditës së Shkollës është organizuar panairi tashmë tradicional i Gjuhës, Artit, Shkencës dhe Teknologjisë P-GJASHT-ë.



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, tha se organizime të tilla janë të dobishme sepse nxisin që nxënësit të jenë më aktiv dhe kërkues për përvoja të reja të studimit në hap me kohën.



Organizatorët e Panairit P-GJASHT-ë 2023 kanë për synim që ky panair të jetë shembull i mirë që mund të ndjeket nga shkollat e Kosovës.

Po ashtu sot kanë udhëtuar në qytetin Osvego në shtetin New York të SHBA-së nxënësit e shkollës fillore “Vëllezërit Frashëri” të cilët do të marrin pjesë në garat Genius Olympiad.

# Koncert festiv për Ditën e Çlirimit të Lipjanit

Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti dhe në kuadër të aktiviteteve të Javës së Kulturës në Lipjan, të hënën me 12 Qershor duke filluar nga ora 19:00 për nder të Ditës së Çlirimit të Lipjanit do të organizohet koncert festiv në sheshin e qytetit “Adem Jashari”.



# Me homazhe tek shtatorja e Komandantit “Adem Jashari”, fillojnë aktivitetet për nder të Ditës së Çlirimit të Lipjanit



Me rastin e 12 Qershorit, Ditës së Çlirimit të Komunës së Lipjanit, nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës z. Imri Ahmeti e të organizuara nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, kanë nisur aktivitetet për shënimin e kësaj dite të rëndësishme.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti i shoqëruar me bashkëpunëtor bëri homazhe dhe ka vendosur buqeta lulesh pranë shtatores së Komandantit Legjendar “Adem Jashari” në qytetin e Lipjanit, për nder të 24 vjetorit të Ditës së Çlirimit të komunës sonë.



# Rrugë të mbarë 51 pelegrinëve nga Lipjani!



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti së bashku me nënkryetarin e komunës z. Diamant Bytyqi kanë marr pjesë në ceremoninë e organizuar nga Bashkësia Islame e Lipjanit për shkuarjen në haxh.



Kryetari i komunës z. Imri Ahmeti ka thënë se ndjehet i nderuar që është i pranishëm në këtë ceremoni për t'iu uruar atyre udhëtim të mbarë dhe të begatshëm për në haxh. Ndjenjë e veçantë për faktin që sot festojmë edhe Ditën e Çlirimit të Lipjanit.

**Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi së bashku me nënkryetarin për komunitete, z. Lulzim Qerimi kanë takuar përfaqësuesit e komunitetit serb në Lipjan, me të cilët kanë diskutuar për qështje dhe kërkesa të ndryshme që vijnë nga ky komunitet.**



**Për nderë të 14 Qershorit Ditës së Dëshmorëve në sheshin “Adem Jashari” janë vendosur fotografit e të gjithë dëshmorëve të Komunës së Lipjanit.**



# Mbahet Akademi Përkujtimore në shënim të 14 qershorit Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Lipjanit Shënimi i kësaj dite nisi me homazhe tek shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari në sheshin e qytetit të Lipjanit, për të vazhduar me akademinë përkujtimore në sallën e Kuvendit të Komunës.



“Sot e 24 vite me parë Vendi ynë e gëzoi lirinë- Atribut që shënon kurorëzimin e përpjekjeve e sakrificave shekullore të shqiptarëve në këto troje duke kulmuar me luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ne lartësojmë e nderojmë gjithë dëshmorët e martirët tanë kur fëmijët tanë, brezat e sotshëm të ndihen mirë në shtetin e tyre, ne i çmojmë e i lartësojmë gjithë dëshmorët e martirët tanë kur Kosovën tonë, komunën tonë e bëjmë vend të sigurt ku mund të punohet e të jetohet me dinjitet si në shtetet e integruara evropiane”, u shpreh Kryetari Ahmeti, duke shtuar se çdo herë duhet të mbajmë të gjallë kujtesën mbi të kaluarën e lavdishme të të rënëve për liri e pavarësi të vendit tonë.

## Komiteti për Komunitete ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 15-të me radhë



Në sallën e takimeve në Komunën e Lipjanit është mbajtur mbledhja e 15-të e Komitetit për Komunitete (KK) udhëhequr nga kryesuesi i komitetit Skender Bikliqi, ku janë shqyrtuar të gjitha pikat e rendit të ditës.

Në këtë mbledhje, u diskutua rreth Kornizes Buxhetore dhe tema të tjera që kanë të bëjnë me komunitetet.



**Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Lipjanit në sallën e Kuvendit të Komunës ka mbajtur debat të hapur publik me përfaqësuesit e bizneseve rreth mbarëvajtjes dhe zbatimit të rregullores për orarin e punës së veprimtarive ekonomike në territorin e Komunës së Lipjanit.**



**“Nuk është ideja që t’i pengojmë dhe dëmtojmë bizneset, jemi të interesuar që të kemi një gjuhë të përbashkët në mënyrë që ndryshimet e kërkuara t’i dërgojmë në Kuvendin Komunal për aprovim. Aktualisht jemi duke i trajtuar në mënyrë të detajuar të gjitha rekomandimet dhe vërejtjet e pranuar nga bizneset në mënyrë që mos të ketë pengesa në zbatimin e saj pas plotësimit ndryshimit të rregullores”, është shprehur nënkryetari Bytyqi.**

# Përrurohet përfundimi i renovimit të objektit të QMF-së në Gadime

Në fshatin Gadime u përrurua përfundimi i renovimit të QMF-së, projektit i realizuar nga Komuna e Lipjanit dhe (AQH) Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor.



“Jam shumë i kënaqur që infrastruktura dhe furnizimet me aparatura të nevojshme kanë shënuar progres dhe tani na duhet përkushtim dhe disiplinë e të gjithëve për të qenë edhe me efikase shërbimet mjekësore”, ka thënë Ahmeti. Kryetari Ahmeti ka falënderuar përrsonelin shëndetësor dhe qytetarët e Gadimes dhe fshatrave për rreth për punën dhe bashkëpunimin e mirë. Ai më pas ndau edhe një mirënjohje sekretarit të parë të ambasadës zvicerane, Laurent Torche.



Nga ana tjetër, z. Laurent Torche ka falënderuar Kryetarin e Komunës Imri Ahmeti ku premtoi më shumë përkrahje për Komunën e Lipjanit. Ai e konsideroi privilegj investimet në këtë qytet.

**Mbahet mbledhja e parë konstituive e Komitetit për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore me vetëm një pikë të rendit të ditës, zgjedhja e Kryesuesit të këtij komiteti.**

**Me të gjitha votat e anëtarëve të Komiteti për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, kryesuese është zgjedhur Majlinda Sylejmani.**





# Mbahet dëgjim publik lidhur me KAB 2024-2026

Nën udhëheqjen e Kryesuesit të Kuvendit Komunës së Lipjanit, z. Daut Azemi është mbajtur dëgjimi publik lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026.



Kryesuesi Azemi ka thënë se ky dokument është tejet i rëndësishëm për Komunën andaj pjesëmarrja dhe ngritja e kërkesave të çdo qytetari në këtë dëgjime është e mirëseardhur.



Dëgjimi është mbajtur me anëtarët e kuvendit, komitetit për politikë dhe financa, komitetit për komunitete, kryetarët e këshillave lokale, dhe grupin e grave.

**Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi së bashku me bashkëpunëtorë ka bërë homazhe dhe ka vendosur Buqeta me lule pranë varrit dhe bustit të Dëshmorit Ibrahim Krasniqi Smallushë, në kujtim të jetës dhe veprës së tij**



**Po ashtu me aktivitete të ndryshme është shënuar edhe dita e kësaj shkolle.**



**Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti kishte për vizitë nxënësit e shkollës “ International Maarif Schools of Kosova“ të shoqëruar nga drejtori i shkollës z. Mustafa Yilmaz dhe përfaqësues të tjerë të kësaj shkolle.**

**Në një atmosferë të hapur dhe të inkurajuar nga kryetari Ahmeti, nxënësit ndanë idetë dhe sygjerimet e tyre për të përmirësuar cilësinë e jetës në Lipjan. Ata diskutuan për çështje të ndryshme duke përfshirë infrastrukturën, arsimin dhe sportin.**




**Kryetari Ahmeti i inkurajoi nxënësit të vazhdojnë të punojnë me zell dhe të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë për të arritur qëllimet e tyre në arsim. Ai theksoi rëndësinë e arsimit cilësor dhe angazhimit të nxënësve në ndërtimin e një të ardhme të ndritur për vete dhe vendin e tyre.**




# Udhëhequr nga nënkryetari i komunës z. Diamant Bytyqi është mbajtur takimi i parë i Komitetit Komunal veprues i themeluar me vendim të kryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti.

Gjatë këtij takimi u diskutua për strategjinë për avancimin e të drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022 – 2026 dhe planin e veprimit 2022 – 2024 si dhe për detyrat dhe përgjegjësitë e këtij komiteti.



Ky komitet komunal veprues do të shërbej si strukturë mbështetëse lokale për koordinimin e aktiviteteve me zyrën për qeverisje të mirë në kuadër të procesit të zbatimit të strategjisë.



**Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, bashkë me zëvendësministrin e Infrastrukturës z. Hysen Durmishi kanë nënshkruar vazhdimin e memorandumeve për projektet e filluara në rrugën Marie Shllaku, rrugën e lumit në Gadime dhe rrugën në Lipjan nga lagjja e Akllapit që lidhet me rrugën regjionale Lipjan - Janjevë.**

**Me këtë rast kryetari Ahmeti theksoi rëndësinë jetike të vazhimit të punimeve në këto rrugë të cilat janë të rëndësishme së veçantë për qytetarët e Lipjanit.**



**Kryetari Ahmeti ka mbajtur takim publik me qytetarë  
Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, në sallën e Kuvendit Komunal ka mbajtur takim publik me qytetarë, të cilët i ka njoftuar ata për punën e gjashtëmujorshit të parë të vitit 2023 të qeverisjes lokale ku bashkarisht kanë diskutuar për të gjitha projektet, të arriturat dhe sfidat të cilat e kanë përcjellura në këtë periudhë.**

Kryetari Imri Ahmeti është shprehur i kënaqur me dinamikën e investimeve kapitale e cila po shënon një rritje në bazë të planifikimit, ku gjatë këtij viti janë planifikuar 98 projekte kapitale, një pjesë e të cilave është duke u realizuar në teren, ndërsa shumë prej tyre janë në fazat e prokurimit dhe shumë shpejtë do të filloj implementimi i tyre.

Po ashtu, Kryetari Ahmeti, ka potencuar se të hyrat e përgjithshme vetanake deri në fund të muajit maj ka arritur të realizohet në 67.50%, me theks të veçantë ka përmendur të hyrat e realizuara nga Tatimi në prone që deri më tani është realizuar 55.23% nga planifikimi për vitin 2023.



Kryetari Ahmeti, para qytetarëve prezent në këtë takim ka prezantuar punët të cila po bëhen në teren, në të njëjtën kohë ai ka ftuar qytetarët që të jenë sa më bashkëpunues sa më aktiv që nëpërmjet sugjerimeve, vërejtjeve dhe kërkesave të bëhen pjesë e pandashme e ndikimit në përmirësimin e jetës së gjithë qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

Nga ana tjetër, qytetarët kanë shprehur falënderime për Kryetarin Ahmeti, për angazhimin në kryerjen e punëve të shumta që po bënë për të përmirësuar jetën e qytetarëve si dhe në të njëjtën kohë ata kanë paraqitur kërkesat për investime në të ardhmen krahas lokaliteteve të tyre e të cilat janë më me prioritet për ta.

**Kryetari Ahmeti ka mbajtur takim publik me qytetarë  
Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, në sallën e Kuvendit Komunal ka mbajtur takim publik me qytetarë, të cilët i ka njoftuar ata për punën e gjashtëmujorshit të parë të vitit 2023 të qeverisjes lokale ku bashkarisht kanë diskutuar për të gjitha projektet, të arriturat dhe sfidat të cilat e kanë përcjellura në këtë periudhë.**

Kryetari Imri Ahmeti është shprehur i kënaqur me dinamikën e investimeve kapitale e cila po shënon një rritje në bazë të planifikimit, ku gjatë këtij viti janë planifikuar 98 projekte kapitale, një pjesë e të cilave është duke u realizuar në teren, ndërsa shumë prej tyre janë në fazat e prokurimit dhe shumë shpejtë do të filloj implementimi i tyre.

Po ashtu, Kryetari Ahmeti, ka potencuar se të hyrat e përgjithshme vetanake deri në fund të muajit maj ka arritur të realizohet në 67.50%, me theks të veçantë ka përmendur të hyrat e realizuara nga Tatimi në prone që deri më tani është realizuar 55.23% nga planifikimi për vitin 2023.



Kryetari Ahmeti, para qytetarëve prezent në këtë takim ka prezantuar punët të cila po bëhen në teren, në të njëjtën kohë ai ka ftuar qytetarët që të jenë sa më bashkëpunues sa më aktiv që nëpërmjet sugjerimeve, vërejtjeve dhe kërkesave të bëhen pjesë e pandashme e ndikimit në përmirësimin e jetës së gjithë qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

Nga ana tjetër, qytetarët kanë shprehur falënderime për Kryetarin Ahmeti, për angazhimin në kryerjen e punëve të shumta që po bënë për të përmirësuar jetën e qytetarëve si dhe në të njëjtën kohë ata kanë paraqitur kërkesat për investime në të ardhmen krahas lokaliteteve të tyre e të cilat janë më me prioritet për ta.

**Fotolajm/ Organizata Humanity First në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit, në prag të festës së Kurban Bajramit kanë shpërndarë pako me produkte mishi, për 60 familje në nevojë, kjo ndihmë ishte si rezultat i marrëveshjes së nënshkruar ditë më parë nga nënkryetari Diamant Bytyqi me përfaqësuesit e Humanity First.**





# KPF zhvilloi punimet e mbledhjes së 17-të me radhë në sallën e takimeve në Komunën e Lipjanit është mbajtur mbledhja e 17 – të e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF).

Me këtë rast, nën udhëheqjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Daut Azemi, u diskutuan pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.



Nga ana tjetër anëtarët e KPF-së, kanë shqyrtuar të gjitha pikat e rendit të ditës dhe i kanë rekomanduar ato për seancën e radhës të Kuvendit të Komunës që mbahet më 30 qershor 2023.

# KPF zhvilloi punimet e mbledhjes së 17-të me radhë në sallën e takimeve në Komunën e Lipjanit është mbajtur mbledhja e 17 – të e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF).

Me këtë rast, nën udhëheqjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Daut Azemi, u diskutuan pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.



Nga ana tjetër anëtarët e KPF-së, kanë shqyrtuar të gjitha pikat e rendit të ditës dhe i kanë rekomanduar ato për seancën e radhës të Kuvendit të Komunës që mbahet më 30 qershor 2023.

# Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti ka shpërndarë çelësat e banesave për 10 familje me gjendje të vështirë ekonomike

Kryetari Ahmeti gjatë ceremonisë së dorëzimit të çelësve për familjet e përzgjedhura ndër të tjera ai ka theksuar se për ne është e rëndësishë së veçantë zgjidhja e çështjes së banimit për familje në nevojë e sidomos sot që në prag të festës së Kurban Bajramit ta bëjmë shpërndarjen e këtyre banesave.



Kryetari Ahmeti, ju urojë familjeve përfituese ti gëzojnë banesat me shëndet për familjet e tyre.

Nga ana tjetër përfituesit e këtyre banesave u shprehën të lumtur dhe falënderuan kryetarin Imri Ahmeti për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në përmirësimin e jetës dhe mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

Ti gëzojnë.

## Kryetari z. Imri Ahmeti u uron qytetarëve festën e Kurban Bajramit

Të dashur qytetarë, uroj që kjo festë të na shërbejë për rritjen e dashurisë dhe respektit, solidaritetit dhe mirëkuptimit mes njëri-tjetrit dhe kujdesit të përbashkët për progresin e komunës dhe vendit tonë.

Ndërsa, neve na mbetet që të punojmë çdo ditë e më shumë dhe të përkustohemi për një jetë më të mirë për qytetarët tonë.



**Kryetari i Komunës, z. Imri Ahmeti së bashku me nënkryetarin z. Diamant Bytyqi kanë pritur bashkatdhetarin nga Sllovia e Lipjanit z. Feti Gerbeshi koordinator i shkollave të qytetit të Martingy (Martini) i shoqëruar nga një grup studentësh së bashku me profesorin e tyre z. Cedric Bonebailt nga Kantoni i Valisit të shtetit të Zvicrës, të cilët kanë grumbulluar mjete financiare për t'ju siguruar nga një pako ushqimore 500 familjeve në nevojë nga vendbanimet e ndryshme të Komunës së Lipjanit dhe një pako me mjete didaktike për klasën e fëmijëve me autizem e cila gjendet në sh.f.m.u Banullë.**



Në këtë rast, kryetari Ahmeti, ka falënderuar studentët zviceran për aktin e tyre human, duke thënë që këto ndihma janë të mirëseardhura në familjet me nevojë të Komunës së Lipjanit. Ai në të njëjtën kohë ka falënderuar bashkatdhetarin Feti Gerbeshi, për ndihmat dhe donacionet e sjellura nga shteti i Zvicrës për qytetarët lipjanas e të cilat nuk janë të pakta.

Nga ana tjetër, bashkatdhetari Feti Gerbeshi ka thënë se me donacione dhe ndihma të tilla për qytetarët lipjanas do të angazhohet edhe në të ardhmen.


# Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka aprovuar Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2024-2026

Udhëhequr nga Kryesuesi, Daut Azemi, Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 20-të me radhë, në të cilën me shumicë votash u aprovuan të gjitha pikat e rendit të ditës.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, nënkryetari Diamant Bytyqi gjatë kësaj seance kanë dhënë sqarime rreth çështjeve të ndryshme që kanë ngritur anëtarët e Kuvendit të Komunës.

# Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



[infokomuna.lipjan@rks-gov.net](mailto:infokomuna.lipjan@rks-gov.net)



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë